



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 44

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 30 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 29.3.2018	Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2018..... 2595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 29.3.2018	Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike..... 2595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 29.3.2018	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve, pjesë të kalendarit për vitin 2018, si “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut” 2616

**VENDIM****Nr. 184, datë 29.3.2018**

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT
DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË
TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL,
PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2018, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është 61 pozicione për kategorinë e ulët drejtuese.

3. Pozicionet, në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil, për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 10, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

Lidhja 1

**Pozicionet në të cilat mund konkurrojnë edhe
kandidatë nga jashtë shërbimit civil**

I. Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm

1. Drejtor i Drejtorisë së Financave, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a;

2. Përgjegjës i Sektorit të Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD, në Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

3. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit IPARD, në Drejtorinë e Kontrollit, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

4. Përgjegjës i Sektorit të Ekzekutimit të Pagesave IPARD, në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

5. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Skemave, në Drejtorinë e Kontrollit, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

6. Përgjegjës i Sektorit të Promocionit dhe Komunikimit, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

7. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Skemave Kombëtare, në Drejtorinë e Kontrollit, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

8. Drejtor i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a;

9. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a;

10. Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1.

VENDIM**Nr. 185, datë 29.3.2018**

**PËR PROCEDURAT E MENAXHIMIT
TË INVESTIMEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Projektinvestimi përfshin një seri punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh që synojnë përmbushjen e një objekti të pandashëm, me qëllime qartësisht të identifikuara. Kostoja totale e një projekti investimi do të përfshijë çdo shpenzim që lidhet me arritjen e rezultateve të synuara, sipas të gjithë komponentëve të tij.

2. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim pragjet minimale dhe maksimale financiare, për secilën kategori të projekteve të



investimeve publike, në bazë të të cilave bëhet klasifikimi i projekteve dhe vlerësimi i tyre.

3. Nivelet e vlerësimit të projekteve të investimeve janë:

- a) vlerësimi i bazë;
- b) vlerësimi i mesëm;
- c) vlerësimi i plotë, të cilit i nënshtrohen projekte që janë me vlerë të plotë, mbi vlerën kufi, të përcaktuar nga ministri përgjegjës për financat.

Projektet e vlerësuara sipas shkronjave “a” dhe “b” do të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

Njësitë e qeverisjes qendrore përgatitin propozimet për projektet e mëdha të investimeve, në çdo kohë, dhe i paraqesin për vlerësim në ministrinë përgjegjëse për financat, brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor, sipas përcaktimit në nenin 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Projektet e investimeve publike paraqiten në përputhje me procedurat e detajuara në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas kalendarit të përgatitjes së buxhetit, miratuar nga ministria përgjegjëse për financat, dhe udhëzimeve standarde të përgatitjes së planit buxhetor afatmesëm. Procesi i përgatitjes, vlerësimit dhe prioritizimit të projekteve të investimeve publike do të kryhet nga ministria që propozon investimin. Në rast të mosplotësimit të të gjitha kërkesave detajuar në aneksin 1, projekti do të refuzohet për financim.

4. Lista e projekteve të reja të investimeve publike që i nënshtrohen vlerësimit të plotë, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të këtij vendimi, përcillet nga ministria përgjegjëse për financat, në Komitetin e Planifikimit Strategjik, brenda muajit dhjetor. Komiteti i Planifikimit Strategjik/NIC shqyrton dhe miraton listën e prioritizuar për çdo sektor, pavarësisht nga burimi i financimit. Kjo listë bëhet pjesë përbërëse e Dokumentit të Politikave Prioritare, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave, brenda muajit janar.

5. Njësitë e qeverisjes qendrore, në kuadër të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, dërgojnë propozimet për projektet e miratuara nga Këshilli i Ministrave në Dokumentin e Politikave Prioritare, si pjesë e kërkesave buxhetore të tyre.

Në këtë fazë shqyrtohet dhe vlerësohet rëndësia strategjike e investimeve të propozuara, kundrejt prioriteteve kryesore strategjike kombëtare.

6. Përfundime nga rregullat dhe procedurat e pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, do të bëjnë vetëm propozimet nga njësitë e qeverisjes qendrore për projekte të mëdha investimi, në këto raste:

- a) Për përballimin e një fatkeqësie natyrore apo në rastet e shpalljes së emergjencës civile;
- b) Kur projektet janë të një rëndësie strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Në çdo rast, këto propozime duhet të dërgohen për shqyrtim, në ministrinë përgjegjëse për financat dhe të përcillen për miratim në Komitetin e Planifikimit Strategjik.

7. Parimet kryesore, ku bazohen ministritë e linjës/institucionet buxhetore për vlerësimin dhe prioritizimin e projekteve të reja të investimeve dhe ministria përgjegjëse për financat për vlerësimin përfundimtar për përfshirjen e tyre në dokumentin buxhetor afatmesëm, si në rastin e projekteve të investimeve nën kufirin e miratuar nga ministri përgjegjës për financat, ashtu edhe për projektet mbi këtë kufi, janë:

- a) vlerësimi i rëndësisë strategjike;
- b) vlerësimi ekonomik dhe financiar;
- c) vlerësimi i menaxhimit të projektit.

Vlerësimi i projekteve bazuar në tri parimet e sipërpërmendura do të bëhet në bazë të pikëzimit, sipas skemës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Financimi i investimeve publike bëhet në përputhje me metodologjinë e përgatitjes së buxhetit, miratuar nga ministria përgjegjëse për financat, në udhëzimet standarde të përgatitjes së buxhetit, ku bëhet diferencimi ndërmjet shpenzimeve për investime të politikave ekzistuese dhe shpenzimeve për investime për politika të reja. Në shpenzimet e investimeve të politikave ekzistuese përfshihen:

- a) shpenzimet e investimeve kapitale që nuk kanë përfunduar dhe që priten të finalizohen;
- b) shpenzimet e investimeve kapitale që ende nuk kanë filluar, por për të cilat janë ndërmarrë angazhimet ligjore dhe që janë miratuar në procesin e mëparshëm të programimit buxhetor afatmesëm (PBA);
- c) shpenzimet e investimeve kapitale që janë financuar në vitin fiskal aktual.



Të gjitha investimet e tjera publike do të trajtohen si politika të reja dhe do të përfshihen në Dokumentin e Politikave Prioritare (DPP).

Miratimi përfundimtar i projekteve të reja të investimit të propozuara bëhet brenda procesit të përgatitjes së PBA-së, me miratimin e DPP-së së rishikuar nga Komitetin e Planifikimit Strategjik, në qershor të çdo viti.

9. Bazuar në DPP-në e miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik, ministria përgjegjëse për financat përgatit dokumentin e PBA-së, duke përfshirë prioritetet buxhetore, miratimin e politikave të reja dhe tavanin e vendosur të shpenzimeve, i cili i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

10. Për projektet e reja të investimeve publike shumëvjeçare, të miratuara si pjesë e dokumentit buxhetor afatmesëm, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre, në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes qendrore nuk duhet të alokohet më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës.

11. Monitorimi dhe raportimi i ecurisë së zbatimit të projekteve të investimeve kryhen sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimet përkatëse të monitorimit të buxhetit të shtetit, si pjesë përbërëse të tij. Procedurat specifike jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS 1. PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE

Procedurat e mëposhtme do të aplikohen në procesin e planifikimit të investimeve publike. “Projekt investimi”, si pjesë përbërëse e programit të shpenzimeve publike është: “një seri punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh, që synojnë të përmbushin një objektiv të pandashëm të një natyre specifike ekonomike apo teknike, me qëllime qartësisht të identifikuara”.

Klasifikimi i Projektit të Investimit bazuar në përkufizimin e mësipërm, zvogëlon fragmentizimin e projekteve në një numër të madh projektesh të vogla.

Në fazën e planifikimit buxhetor të shpenzimeve për investime, për një menaxhim sa më efektiv të tyre, ndahen në dy grupe kryesore:

- Grupi I – Shpenzime administrative kapitale - ku përfshihen shpenzimet kapitale për blerje pajisjesh dhe mobilimi zyre, sistemeve kompjuterike dhe IT etj.

- Grupi II – Shpenzime për projekte investimesh:

a) Shpenzime kapitale në infrastrukturë – ku përfshihen projektet e investimeve për ndërtime të reja apo rikonstruksione/rehabilitime sipas fushave të përgjegjësisë së Institucioneve Buxhetore. Këtu mund të përfshihen edhe blerjet e pajisjeve të mëdha teknologjike (p.sh., blerjet e pajisjeve mjekësore për spitalet dhe qendrat shëndetësore, kabinetet për shkollat, ekskavatorët etj.). Kosto e përgjithshme të këtyre projekteve përmban çdo shpenzim i lidhur me arritjen e produktit të synuar, p.sh.: projekti i ndërtimit/rehabilitimit të një rruge, shkolle apo spitali etj., do të përfshijë koston e *output*-eve përbërës të projektit si: shpronësimi tokës, leja ndërtimore, hartimi i projektit, zbatimi të punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi etj.

b) Shpenzime kapitale për zhvillim të kapaciteteve - ku përfshihen projektet studimore në fusha të ndryshme, të Asistencës teknike, për ngritje kapacitetesh të burimeve njerëzore etj.

Cikli i Projektit konsiderohet si pjesë integrale e Ciklit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike (MSHP). Mund të ndodhë që cikli i një projekti mund të mos përputhet nga pikëpamja kohore me ciklin e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike.


Kjo për arsyen:

së pari: se cikli i MSHP duhet të përputhet në mënyrë të plotë me kalendarin e një viti fiskal, ndërsa fazat e një projekti individual mund të jenë më të gjata se sa fazat korresponduese të MSHP;

së dytë: mund të ndodhë që disa projekte financohen nga donatorët dhe zakonisht donatorë të ndryshëm mund të kenë cikle dhe procedura të ndryshme nga ato të MSHP. Në këtë kontekst këto procedura synojnë të ndërtojnë një proces që lidh në mënyrë integrale procesin e menaxhimit të

projekteve të investimeve me procesin e përgjithshëm të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike.

Diagrami i mëposhtëm përshkruan fazat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike.



Proceset dhe procedurat e secilës fazë të ciklit janë të rëndësishme sepse sigurojnë faktin që projekti do të menaxhohet në mënyrë efektive dhe do të arrijë qëllimin e tij.

1. Identifikimi i projektit është procesi i identifikimit e shqyrtimit të ideve për projekte investimi të bazuara në analizën e nevojave publike, ndërhyrjeve të qeverisë dhe përshtatjes me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

2. Vlerësimi dhe përgatitja e projektit është procesi i analizës dhe vlerësimit të efektivitetit ekonomik dhe financiar, si dhe i mundësisë së realizimit të projektit;

3. Aprovimi dhe financimi i projektit është faza në të cilën projekti shqyrtohet/aprovohet për financim nëpërmjet procesit të përgatitjes dhe financimit të PBA-së së Institucionit Buxhetor përkatës;

4. Zbatimi i projektit është faza në të cilën projekti zbatohet dhe realizohen *output*-et e tij;

5. Monitorimi i zbatimit të projektit është procesi përmes të cilit ministrinë dhe në veçanti institucionet përgjegjëse për zbatimin e projekteve sigurojnë që aktivitetet që ata po zbatojnë janë në përputhje me aktivitetet e programuara.

6. Vlerësimi dhe Auditimi është faza e ciklit në të cilën raportimi për zbatimin fizik dhe financiar të projektit auditohet kundrejt rregullave financiare dhe realizimit të treguesve të performancës së projektit. Objekt i raportimit dhe monitorimit nga ana e ministrive dhe institucioneve buxhetore që zbatojnë projekte të investimeve publike, do të jenë të gjitha projektet e investimeve publike që financohen në kuadër të buxhetit të shtetit, pavarësisht burimit dhe vlerës së financimit.

FAZAT nëpër të cilat kalon procesi deri në miratimin e projektit të investimit janë:

FAZA I – Identifikimi i projekt-idesë nëpërmjet analizës së problemit dhe argumentimit për investim (hapi 1, hapi 2, hapi 3);

FAZA II – Përgatitja Propozimit të Projektit të Investimit (hapi 4);

FAZA III – Analiza, Miratimi dhe Financimi i Projekt-Propozimeve të Investimeve Publike (hapi 5, hapi 6, hapi 7).



Hapat kryesorë të ndjekur sipas fazave të mësipërme në mënyrë skematike janë:

Hapi 1	Hapi 2	Hapi 3	Hapi 4	Hapi 5	Hapi 6	Hapi 7
Identifikim i projektit	Rishikimi projekt idesë nga EMP	Rishikimi projekt idesë nga SP, GMS	Përgatitja dhe vlerësimi i detajuar i projektit	Rishikimi vlerësimi dhe miratimi nga MF	Rishikimi nga Këshilli i Ministrave	Miratimi i projektit dhe përfshirja në PBA/ buxhetin vjetor

Hapi 1 – Identifikimi i projekt-idesë

Projekt-idetë për investime prezantohen nga “Propozuesit e Projektit” (ose siç quhen ndryshe, “Menaxherët e Projektit”), të cilët janë përgjegjës për Programin në të cilin bën pjesë projekti i investimit.

Tre elementët bazë të fazës së identifikimit të projekt-idesë janë:

Analiza e prioritetëve ----- është një analizë e prioritetëve sektoriale dhe kombëtare.

Analiza e problemeve ----- është një analizë për identifikimin e problemeve që ekzistojnë duke i renditura ato sipas rëndësisë së tyre, duke identifikuar një relacion të mundshëm shkak- pasojë.

Analiza e Nevojave dhe përkufizimi i objektivave të investimit ----- krijimi i një pikturë të situatës, ku aspektet negative konvertohen në zgjidhje, të cilat më vonë kthehen në objektiva që duhen përmbushur.

Projekt-idetë prezantohen në Formularin 1 (F-1) – bashkëlidhur këtij Aneksi.

Formulari i Identifikimit të Projekt-Idesë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

i) Emri i Propozuesit të Projektit - Zyrtari që përgatit Formularin e Projekt-Idesë dhe detajet kontaktuese.

ii) Emri i Institucionit Buxhetor - p.sh., Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

iii) Vendndodhja - Vendi ku do të kryhet investimi.

iv) Ideja e Projektit - Një përshkrim i shkurtër i idesë së projektit.

v) Problemet që do të adresohen - Një shpjegim i shkurtër dhe i qartë i problematikës së gjendjes aktuale, e cila pengon arritjen e qëllimeve dhe objektivave të politikave të programit dhe mënyrën se si projekti i propozuar ndihmon në kapërcimin e problematikës aktuale

vi) Emri i Programit - Ky është emri i programit ashtu siç shfaqet në Dokumentin e PBA-së dhe buxhetit vjetor;

vii) Vlerësimet paraprake të kostove - Një vlerësim paraprak i kostos së parashikuar të projektit

Hapi 2 – Rishikimi i Projekt-idesë nga DEMP

Formulari-1 (F-1) dorëzohet tek Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Projektit (DEMP).

EMP-ja duhet të diskutojë mbi (i) idenë e projektit për investim, (ii) mbi problemet që do të adresohen nga projekti dhe (iii) koston paraprake të investimit në fjalë.

DEMP-ja mund të pranojë ose të refuzojë projekt-idenë. Në rast të refuzimit, në Formularin -1, jepet një shpjegim i shkurtër dhe i qartë i arsyeve për refuzimin e projekt-idesë.

Në rast pranimi, DEM-ja duhet të dorëzojë Formularin-1 tek Sekretari i Përgjithshëm ose tek drejtuesi i institucionit buxhetor, nëse nuk ka Sekretar të Përgjithshëm.

Hapi 3 – Rishikimi i Projekt-idesë nga Sekretari i Përgjithshëm (SG), Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)

Sekretari i Përgjithshëm duhet të bëjë një vlerësim paraprak mbi domosdoshmërinë e një ndërhyrjeje me investim publik në fushën përkatëse dhe njëkohësisht vlerëson nëse informacioni i dhënë në Formularin-1 siguron faktin që projekti është i pranueshëm dhe i realizueshëm nga pikëpamja financiare dhe teknike. Më pas, në rast pranimi e përcjell për miratim në GMS.

Arsyet për pranimin ose refuzimin e projekt-idesë nga Sekretari i Përgjithshëm jepen në Formularin 1, në seksionin përkatës.



FAZA II: Përgatitja Propozimit të Projektit të Investimit

Hapi 4 – Përgatitja dhe vlerësimi i detajuar i projektit - Plotësimi i Formularit të Projektit të Investimit (FPPI) – F-2

Përshkrim i investimit, së bashku me alternativat e konsideruara, duhet të prezantohet në Formularin 2 – Propozimi i Projektit të Investimit (FPPI).

Hapat kryesore nëpërmjet të cilave kalon vlerësimi dhe formulimi i një projekt investimi do të jenë:

a) Identifikimi i Alternativave (Opsioneve)

Ky hap përfshin identifikimin e një liste alternativash, të cilat qeveria mund t'i ndërmarrë për të arritur rezultatin dhe objektivat e dëshiruara të investimit. Identifikimi dhe analizimi i detajuar i alternativave i ndihmon nivelet e mësipërme të vendimmarrjes për të kuptuar veprimet e mundshme që duhet të ndërmerren për zgjidhjen e problemeve aktuale.

Lista e alternativave duhet të përfshijë të paktën tre opsionet e mëposhtme:

- i) “nuk investohet”
- ii) “investim minimal”
- iii) “investim i konsiderueshëm”

Në alternativën “nuk investohet” vazhdohet me situatën aktuale, pa u ndërmarrë asnjë aktivitet investimi shtese. Kjo ndihmon për evidentimin dhe analizën e pasojave nëse projekti nuk realizohet.

Në alternativën “investim minimal” ndërmerren veprime minimale të nevojshme për ta lehtësuar problemin. Alternativat “investim minimal” zakonisht sigurojnë një zgjidhje të pjesshme të problemit.

Në alternativën “investim i konsiderueshëm” nevojat e investimit adresohen në mënyrë më të plotë kundrejt një kostoje investimi më të lartë. Këto opsione zakonisht ofrojnë zgjidhje më komplekse të problemit.

Alternativat “nuk investohet” dhe “investim minimal” duhet të konsiderohen patjetër në shortlistën e alternativave, për të shërbyer si bazë krahasimi për më tej (“investim i konsiderueshëm”).

b) Vlerësimi i alternativave (opsioneve) të investimit

Analiza e alternativave është një pjesë shumë e rëndësishme e analizës së investimit. Qëllimi i zhvillimit të opsioneve alternative është që të ndihmoj në gjetjen e një zgjidhjeje efektive dhe ekonomike të përdorimit të fondeve, që përmbush rezultatet e dëshiruara dhe objektivat e ndërhyrjes me investimin.

Fillimisht është e rëndësishme që të bëhet një vlerësim i shpejtë i alternativave të identifikuara me qëllim eliminimin në fazën fillestare të atyre alternativave, të cilat për arsye të ndryshme mund të mos jenë të realizueshme.

Ekzistojnë tri procese themelore në të cilat duhet të kalojë një alternativë, të cilat ndihmojnë në kryerjen e një vlerësimi të shpejtë:

- i) Output – Ka një kërkesë për këtë investim?
- ii) Input – A janë *inputet* që nevojiten në dispozicion (e të arritshme)?
- iii) Procesi i zhvillimit – A është mënyra më efiçente e shndërrimit të *inputit* në *output*?

E mira e kësaj metode (vlerësimi i shpejtë) është se mund të aplikohet në të gjitha llojet e alternativave, qofshin ato *inpute/outpute* financiare apo fizike.

Për investime në vlerë të vogël, kjo formë e vlerësimit është e vetmja që kërkohet apo që është e mundur të bëhet. Ndërsa për investimet me vlera të mëdha do të kërkohet një studim më i plotë dhe analiza kosto-përfitim.

c) Krijimi i listës së reduktuar të alternativave për vlerësimet e detajuara

Është e nevojshme të krijohet një listë e reduktuar e alternativave. Sidoqoftë, kjo listë duhet të mbulojë një gamë të gjerë të alternativave potenciale që duhet të konsiderohen për arritjen e objektive të investimit.

- Si rregull, alternativat e investimit duhet të identifikohen për të gjitha nivelet e vlerësimit.

- Për projekte investimi të vogla – “Kategoria I”, disa alternativa investimi duhet të identifikohen, por kostot dhe të ardhurat duhet të llogariten/vlerësohen vetëm për alternativën e preferuar (rekomanduar), sikurse tregohet në formatin F – 2, FPPI.



- Për projekte investimi të mëdha – “Kategoria II e III”, - vlerësimet e alternativave duhet të bëhen për të paktën dy ose tre alternativa, “investim minimal” dhe “investim i konsiderueshëm”, përfshi edhe alternativën e preferuar/të rekomanduar.

d) Nivelet e vlerësimit të aplikuar sipas procedurave të MIP

Nëse ideja e investimit konsiderohet efektive dhe ekonomike për zgjidhjen e problemeve aktuale, atëherë projekti duhet të kalojë në fazën e mëtejshme për një vlerësim më të detajuar, bazuar në tre nivelet e përcaktuara më poshtë (tab. 1):

Tab. 1

000/lekë

Tipi i vlerësimit (analizës)/Sektori	Sektori i Infrastrukturës	Sektorët e tjerë	Formulari që kërkohet
(i) Vlerësimi bazë Kategoria I	Deri në 300.000	Deri në 150.000	F-2 F-2 (FPPI) Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit
(ii) Vlerësimi i mesëm Kategoria II	Mbi 300.000	Mbi 150.000	F-2 (FPPI) shoqëruar me Analizë të plotë ekonomike- financiare, studim të pjesshëm ose të plotë fizibiliteti
(iii) Vlerësimi i Plotë Kategoria III mbi vlerën kufi të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat	Projektet e mëdha me vlerë mbi kufirin e përcaktuar nga ministri përgjegjës për financat, duhet të përmbajnë studim të plotë fizibiliteti dhe do të kalojnë për shqyrtim dhe miratim në Komitetin për Planifikimin Strategjik.		

Projektet e investimit që nuk do të nënshtrohen vlerësimit sipas niveleve të tabelës së mësipërme do të jenë:

1. Projektet e klasifikuara në Grupin I (Shpenzime administrative kapitale)- që nuk konsiderohen si “projekte investimi”, dhe do të jenë pjesë e listës së shpenzimeve kapitale për IB përkatës, duke u konsideruar si politika ekzistuese të domosdoshme për zëvendësimin e aktiveve të amortizuara.

2. Projektet e klasifikuara në Grupin II (Shpenzime për projekte investimesh) :

Shpenzime kapitale në infrastrukturë – për vlerën nën 3,000,000 lekë,

Shpenzime kapitale për zhvillim të kapaciteteve – do të shoqërohen vetëm me informacion të plotësuar sipas Formularit 1.

Niveli i Vlerësimit dhe Informacioni i kërkuar, i cili pasqyrohet në plotësimin e formularit F-2.

Niveli i Vlerësimit (analizës)	Informacioni i Kërkuar
1 – Vlerësimi Bazë (“Kategoria I” e projekteve)	Pikat e kontaktit - Emri i Institucionit Buxhetor/kodi - Emri dhe pozicioni i propozuesit të projektit - Detajet e kontaktit me propozuesin e projektit. Të dhëna mbi drejtorinë e buxhetit - Personi i kontaktit të Buxhetit & Financës - Detajet e kontaktit të Buxhetit & Financës Identifikimi i Investimit - Ministria/grupi/sektori/Kodi i Grupit - Emri Programit/Kodi - Emri Projektit/Kodi - Numri i identifikimit nga DMIP - Vendndodhja e Projektit - Statusi aktual - i ri/në vazhdim



	- Statusi i financimit nga donatori (nëse ka) - Data e fillimit/Data e përfundimit Justifikimi i Investimit - Problemet e situatës aktuale që duhen adresuar/Justifikimi i nevojës për investim - Përputhja e projektit me qëllimet dhe objektivat e Programit, të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen. Specifikimi i Projektit & Analiza e Alternativave (opsionet) të Investimit - Qëllimi i projektit (Objekti i Investimit) - Alternativat që do të analizohen - Përshkrimi për çdo alternativë - Alternativa e përzgjedhur (rekomanduar) - Arsytet e përzgjedhjes së kësaj alternative - Produktet dhe përfitimet e projektit të investimit - Kostot për njësi të produktit të realizuar Vlerësimi i Kostos dhe i Përfitimeve - Kosto e parashikuar për dy vitet e mëparshme (në rastin e projekteve shitesë kontrate) - Kosto totale e investimit (Shpenzimet kapitale 230-232) - Kosto e investimit për tre vitet e ardhshme - Kosto e mbetur e investimit pas tre vitesh - Kosto periodike (shpenzimet korente) si rezultat i investimit - Të ardhurat e siguruara (nëse ka) - Financimi i donatorëve (nëse ka) - Kostoja neto Menaxhimi i Projektit – Supozimet dhe Rreziqet - Supozimet dhe Rreziqet në zbatimin e projektit dhe veprimet e planifikuara për eliminimin e efektit të tyre - Përmbledhje e mënyrës dhe rolit të institucioneve, që do të menaxhojnë projektin Informacione të tjera - Lista e dokumenteve - Informacione të tjera Autorizuesit – nivelet e shqyrtimit të projektit dhe personat përkatës
2 – Vlerësimi i Mesëm (“Kategoria II” e projekteve)	<i>(përveç informacioneve të vlerësimit bazë, si më lart)</i> - Vlerësimi financiar dhe ekonomik i alternativave të investimit - Tabela e Analizës Kosto-përfitim. Të plotësohet për të paktën 2 alternativa (opsione) të investimit, në bazë të identifikimit të paktën të tre alternativave ekuivalente “nuk investohet” – “investim minimal” – “investim i konsiderueshëm” - Alternativa e përzgjedhur (rekomanduar) - Arsytet në zgjedhjen e alternativës së rekomanduar - Tregoni me anë të plotësit me X të kutisë, nëse janë përgatitur dokumentet e mëposhtme (i) hartimi i projektit (ii) Studimi i para-fizibilitetit të zhvilluar



	(iii) Studimi i pjesshëm i fizibilitetit (iv) Analiza të tjera ekonomiko-financiare - Tregoni me anë të plotësit me X të kutisë, nëse nëse janë kryer vlerësimet e mëposhtme (i) vlerësimi mjedisor (ii) vlerësimi i impaktit social (iii) vlerësimet të tjera – (nëse ka) Informacione të tjera Autorizuesit – nivelet e aprovimit
3 – Vlerësimi i plotë	(përveç informacioneve të vlerësimit të mesëm, si më lart) - Të jepen treguesit kryesorë të kësaj analize: VAN (Vlera aktuale Neto), NBR (Norma e Brendshme e Kthimit), RKP (Raporti Kosto-Përfitim); - Analizat e plota ekonomiko-financiare; - Studimi i plotë i fizibilitetit; - Skenarët e rrjedhjes së parasë dhe financimit - Vlerësimet e impakteve mjedisore, sociale dhe analiza të tjera që nevojiten - Të tjera, sipas rastit

e) Llogaritja dhe Vlerësimi i kosto-përfitimeve të alternativave të investimit

Është e rëndësishme llogaritja dhe vlerësimi i saktë i kostove dhe përfitimeve (të ardhurave) që çdo investim sjell për Qeverinë (Buxhetin e Shtetit) dhe shoqërinë (publiku). Mbi bazën e këtyre llogaritjeve, vendimmarrësit mund të krahasojnë treguesit për të përzgjedhur alternativën më të mirë të mundshme për investimin.

Kostot dhe përfitimet relevante janë ato kosto apo përfitime që ndikohen nga kryerja e investimit.

➡ *Vlerësimi i kostove*

Kostot totale duhet të përfshijnë kostot direkte, indirekte dhe shpenzimet korente.

Disa projekte mund t'i sjellin qeverisë detyrime dhe obligime shtesë në të ardhmen nëse realizohet investimi. Ky parashikim gjithashtu duhet të përfshihet në vlerësim dhe të monitorohet nëse projekti vazhdon. Një shembull për këtë mund të jetë pagesa për shpronësime të tokës etj.

Amortizimi dhe interesat nuk duhet të përfshihen në këto vlerësime si kosto financiare (edhe pse në kontabilitet këto zëra përbëjnë një informacion të rëndësishëm).

➡ *Vlerësimi i përfitimeve*

Qëllimi i vlerësimit të përfitimeve bëhet me arsyen për të parë nëse të mirat dhe përfitimet nga realizimi i investimit justifikojnë kostot e tij.

Përfitimet duhet të vlerësohen në terma financiar (në formën e të ardhurave) me përjashtim të rasteve kur llogaritja e tyre në terma monetar është e pamundur të realizohet. Sidoqoftë, edhe pse nuk është i mundur vlerësimi i të gjithë përfitimeve në terma monetarë, është me rëndësi marrja parasysh e tyre në krahasimin e diferencave ndërmjet alternativave të investimit.

➡ *Efektiviteti i Kostos – Metoda e Analizës së Kostos më të Ulët*

Efektiviteti i koston përbën një kriter për krahasimin e kostove të alternativave të mundshme që realizojnë *output* të njëjtë, ose e thënë ndryshe mënyra më efektive e realizimit të objektivit të investimit, apo thjesht alternativa që ka koston më të vogël për arritjen e të njëjtë rezultat.

Kur përfitimet nga realizimi i investimit nuk mund të maten monetarisht, kriteri i efektivitetit së koston është i vetmi që do të përdoret duke qenë se kosto është i vetmi element i njohur. Ky proces konsiston thjesht në llogaritjen e të gjitha kostove, ato kapitale dhe periodike të një alternative, skontimin e fluksit të tyre ndër vite, për të siguruar vlerën e tanishme (aktuale) të kostove. Alternativa me vlerën aktuale (e tashme) më të vogël është alternativa më e mirë. Duhet pasur parasysh se nëse alternativat kanë ndryshime të konsiderueshme në nivelet e *output-it*/rezultatit që ofrojnë, krahasimet e mësipërme janë të pavlefshme. Në këto raste preferohet dhe rekomandohet të përdoret metoda e koston më të ulët për njësi.



Në investimet ku nuk ka përfitime monetare, por ato mund të maten në mënyra të tjera (numri i pacientëve të trajtuar, numri i studentëve, etj.) është me rëndësi të konsiderohen treguesit e eficiencës së kostos. Bashkangjitur Aneksit 1 gjeni tabelën me disa shembuj të treguesve të eficiencës së kostos.

➡ Identifikimi i risqeve

Risku është e një faktor i jashtëm i pakontrollueshëm që ka ndikim mbi investimin.

Hartuesi i një investimi duhet të përcaktoj risqet e pritshme gjatë jetëgjatësisë së një projekti investimi si dhe masat për menaxhimin e tij.

Menaxhimi i riskut ka të bëjë me:

- identifikimin e risqeve të mundshme përpara fillimit të investimit dhe ngritjen e një mekanizmi mbrojtës që do të pengonte materializimin e tyre dhe ndikim negativ që do të kishin mbi investimin në rast se materializohen;

- ngritjen e një mekanizmi për monitorimin e risqeve dhe përditësimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme;

- ngritjen e mekanizmit të duhur për kontrollin e pasojave negative në rast se risqet e parashikuara materializohen;

- një proces efektiv marrje-vendimi që do të mbështetej nga korniza e analizës dhe vlerësimit të riskut.

➡ Metoda e Analizës Kosto-Përfitim

Tri janë treguesit kryesorë që përdoren në analizën kosto-përfitim:

- i) Vlera Aktuale Neto (VAN). Teorikisht sa më e lartë të jetë VAN aq më i dëshirueshëm është një projekt;

- ii) Norma e Brendshme e Kthimit (NBR). Kriteri i NBR lejon që të pranohen apo refuzohen projektet e mundshme nëse NBR-ja e tyre është mbi ose nën një vlerë të caktuar si tavan.

- iii) Raporti Kosto-Përfitim (RKP). Ky raport na lejon të dallojmë opsionet për të cilat VAN është më e lartë pavarësisht nga NBR që ka secili prej opsioneve.

➡ Përzgjedhja e alternativës më të mirë (të rekomanduar)

Alternativa më e mirë (e rekomanduar) duhet të përzgjidhet pasi është bërë identifikimi, vlerësimi dhe përshkrimi i të gjitha kostove, përfitimeve dhe risqeve, aty ku vlerësimi i tyre është i mundshëm.

Pas analizave të mësipërme dhe plotësimit të Formularit F-2, kalohet në fazat e mëposhtme të shqyrtimit dhe miratimit të projektit të propozuar.

f) Rishikimi i Propozimit të Projektit për Investim nga DEMP-ja

Me marrjen e Formularëve 2, Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Projektit (DEMP) duhet të mbledhë Ekipin e Menaxhimit të Projektit (EPM), për të diskutuar mbi propozimin e projektit për investim, koston dhe përfitimet e tij dhe përcjelljen e propozimit të projektit për investim, në Departamentin e Financës dhe Departamentin e Politikave.

e) Rishikimi i Propozimit të Projektit për Investim nga Departamenti i Financës dhe Buxhetit dhe Departamenti i Politikave

DEMP-ja duhet të diskutojë me Departamentin e Buxhetit/Financës të institucionit mbi propozimin e projektit për investim e sidomos mbi llogaritjet e kostos dhe përfitimit të projektit të investimit në fjalë, duke përfshirë këtu edhe mundësitë buxhetore të institucionit për ta përballuar këtë investim.

1.7 Rishikimi i Projekt Propozimit nga Sekretari i Përgjithshëm (SP)

Sekretari i Përgjithshëm vendos nëse projekti duhet t'i kalojë Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS). Në rast se SP e pranon propozimin e projektit të investimit, më pas ai/ajo ia paraqet për shqyrtim GMS të institucionit përkatës.

1.8 Rishikimi i Projekt Propozimit nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)

Pas miratimit nga GMS, çdo Ekip i Menaxhimit të Programit duhet të prioritetizojë projektet e investimeve të çdo programi respektiv, për përfshirjen e tyre në PBA/buxhetin vjetor. Projekt propozimet për investime të mëdha mund të kalojnë tavanin e miratuar për Institucionin Buxhetor.

Ministria e Linjës/Institucioni Buxhetor harton një listë e projekteve të reja e cila prioritetizohet bazuar në vlerësimin sipas një sistemi pikëzimi.



Parimet kryesore mbi të cilat do të mbështetet ky vlerësim do të jenë:

- Vlerësimi i rëndësisë strategjike – lidhja e projekt propozimit me strategjitë dhe prioritetet e qeverisë;
- Vlerësimi ekonomik dhe financiar – përfitimet totale të projekt-propozimit duhet të jenë më të larta se kostot totale të financimit;
- Vlerësimi i menaxhimit të projektit – projekt-propozimi duhet të ketë një plan të qartë dhe gjithëpërfshirës të realizimit dhe menaxhimit të riskut për të siguruar zbatimin e suksesshëm të tij.

Tabela e mëposhtme paraqet të detajuar sistemin e vlerësimit/pikëzimit për projektet e reja.


Kriteret	Informacioni kërkuar	Vlerësimi me pikë
1.1 Përputhja e projektit me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.	1.1.1: A përputhen objektivat e projektit me një nga prioritetet e SKZHI?	- Plotësisht 15-30 pikë - Pjesërisht 0-15 pikë - Nuk përputhen- o pikë
	1.1.2: A përputhen objektivat e projektit me një nga objektivat strategjike të SKZHI? A është pjesë e Dokumentit të Politikave Prioritare?	- Plotësisht 15-30 pikë - Pjesërisht 0-15 pikë - Nuk përputhen- o pikë
1.2 Përputhja e projektit me Strategjinë Sektoriale	1.2.1: A përputhen objektivat e projektit me një nga objektivat e strategjisë sektoriale?	- Plotësisht 15-30 pikë - Pjesërisht 0-15 pikë - Nuk përputhen - o pikë
1.3 Përputhja e projektit me prioritetet vjetore të programit të Qeverisë dhe përfshirja në PBA	1.4.1: A është projekti pjesë e dokumentit të prioritetëve të politikave?	- Plotësisht 15-30 pikë - Pjesërisht 0-15 pikë - Nuk përputhen- o pikë

Totali 100

2.1: Situata aktuale dhe nevoja për investim.	2.1.1: A është përshkruar situata aktuale (përfshirë problemet)?	10
	2.1.2: A është përcaktuar arsyeja për investim?	10
2.2: Alternativat për investim/ Produktet/	2.2.1: A janë përgatitur alternativat e investimit?	10
	2.2.2: A janë përcaktuar produktet e projektit?	20
2.3 Kostot e investimit/ Analiza kosto përfitim, Analiza e efektivitetit të koston apo analiza të tjera të efektivitetit ekonomik	2.3.1: A janë përcaktuar kosto totale të investimit? A janë të njohura dhe të identifikuar koston korente?	20
	2.3.2: A janë realizuar analiza të tjera ekonomike-financiare? ose 2.3.3: A është kryer analiza Kosto-Përfitim?	20
	A ka kuptim rezultati i saj? (Treguesit financiar VAN, NBR)	
2.4: Impakti/efekti mjedisor, social etj.	2.4.1: A është përcaktuar efekti mjedisor? A nevojitet vlerësimi i Ministrisë së Mjedisit?	5
(I nevojshëm për vlerësimin e mesëm dhe të plotë)	2.4.2: Si do të ndihmojë projekti në uljen e varfërisë? Si do të ndihmojë projekti shërbimet publike/ përfitimet publike të grave, vajzave dhe pjesëtarët e komuniteteve rezidente në Shqipëri?	5

Totali 100

Diagrami e mëposhtme përshkruan procesin e vendimmarrjes në lidhje me përgatitjen dhe analizën e investimeve publike në Institucionet Buxhetore.



FAZA III: Analiza, Miratimi dhe Financimi i Projekt-Propozimeve të Investimeve Publike

Hapi 5 – Paraqitja e projekt-propozimit të investimit nga Institucionet Buxhetore Ministrisë përgjegjëse për financat: Projekt-propozimet e investimeve përcillen në Ministrinë përgjegjëse për financat:

- nëpërmjet paraqitjes normale të kërkesave për shpenzime sipas afateve të PBA-së/Buxhetit Vjetor;
- Përrashtim nga ky rregull, do të bëjnë vetëm ato propozime projektsh të mëdha investimi, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- i) Përballimin e një fatkeqësie natyrore apo shpalljes së emergjencës civile;
- ii) Kanë rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Në çdo rast, këto propozime duhet të depozitohen për shqyrtim në Ministrinë përgjegjëse për financat dhe përcillen për miratim në Komitetin e Planifikimit Strategjik.

- *Analiza e Projekt-Propozimeve nga Ministria përgjegjëse për financat*

Pasi propozimet mbërrijnë në Ministrinë e përgjegjëse për financat, Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit i delegon ato në Drejtorinë e Analizës dhe Programit Buxhetor (DAPB), e cila është përgjegjëse për mbledhjen e të gjitha kërkesave për shpenzime në kuadër të PBA-së/Buxhetit Vjetor për çdo institucion buxhetor, sektor/program si dhe në Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike (DMIP) për rishikim dhe vlerësim përfundimtar.

Pas shqyrtimit të formularëve shoqërues për projektet e reja (F 2) dhe listës së prioritizuar të projekteve të investimeve nga ana e Ministrive të Linjës/Institucioneve Buxhetore, është Ministria përgjegjëse për financat e cila pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre, harton listën përfundimtare të projekteve të investimeve publike të renditur sipas prioriteteve strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit. Për vlerësimin dhe përcaktimin e prioriteteve të projekteve të reja të investimeve do të mbahen në konsideratë elementët e mëposhtëm të çdo projekti:

- Përputhja me prioritetet kombëtare të përcaktuara në dokumentet strategjike të vendit;
- Kthimin e pritshëm financiar të projektit (IRR, NPV);

- Niveli i përgatitjes së projektit (korniza ligjore, institucionale, studimet e fizibilitetit, mjedisore) etj.

Financimi i investimeve publike, bëhet në përputhje me metodologjinë e përgatitjes së buxhetit, miratuar nga MFE në udhëzimet standarde të përgatitjes së buxhetit, ku bëhet diferencimi, ndërmjet shpenzimeve për investime të politikave ekzistuese dhe shpenzimeve për investime për politika të reja.

Në shpenzimet e investimeve të politikave ekzistuese përfshihen:

- i) shpenzimet e investimeve kapitale që nuk kanë përfunduar dhe që priten të finalizohen;
- ii) shpenzimet e investimeve kapitale që ende nuk kanë filluar por për të cilat janë ndërmarrë angazhimet ligjore dhe janë miratuar në procesin e mëparshëm të Programimit Buxhetor Afatmesëm;
- iii) shpenzimet e investimeve kapitale që janë financuar në vitin fiskal aktual.

Shpenzimet për projekte investimesh të politikave ekzistuese do të konsiderohen me prioritet të lartë dhe do të përfshihen të parat në tavanet buxhetore të miratuara.

Shpenzimet e investimeve për projektet e reja do të financohen në varësi të hapësirës fiskale të mbetur (pas akomodimit të projekteve ekzistuese). Këto shpenzime do të trajtohen si politika të reja dhe do të përfshihen në Dokumentin e Politikave Prioritare (DPP).

Gjatë procesit të planifikimit të shpenzimeve për projekte investimi, duhet të mbahet në konsideratë neni 40 i LOB sipas të cilit: “ për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës”.


Hapi 6 Rishikimi nga Këshilli i Ministrave

Pasi rishikohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe diskutohet me institucionet buxhetore, në dëgjesat që organizohen në kuadër të PBA-së, drafti i PBA-së, si dhe Buxheti Vjetor paraqitet në Këshillin e Ministrave për rishikim përfundimtar dhe miratim.

Hapi 7 Miratimi përfundimtar

Pas miratimit në KM të projekteve të investimeve në kuadër të PBA/buxhetit vjetor, lista e projekteve të investimeve paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë vetëm si tabelë shoqëruese e paketës së PBA/Buxhetit vjetor, por që nuk miratohet nga Kuvendi.

Diagrami i mëposhtëm pasqyron procesin e vendimmarrjes për analizën, miratimin dhe financimin e projekt – propozimeve të investimeve publike.




Tregues të eficiencës së kostos – (*shembuj*)

Ujësjiellës:	- Kosto për frymë (në raport me të ardhurat) - Konsumi për frymë - Numri i rasteve të të sëmurëve nga përdorimi i ujit
Arsimi:	- Numri i nxënësve për klasë - Raporti nxënës/mësues - Kosto për metër katror e klasës - Kosto e investimit për nxënës - Kosto vjetore për nxënës
Shëndetësia:	- Kosto për pacient - Kosto për shtrat - Hapësira për shtrat - Koeficienti i përdorimit të shtretërve - Numri i pacientëve për shtrat - Raporti mjek/infermiere - Staf mjekësor/numri i pacientëve - Staf mjekësor/numri i shtretërve - Kosto e vaksinimit për person - Mesatarja e ditëve të shtrimit të pacientëve
Transporti:	- Ngarkesa e trafikut (automjete në ditë etj.) - Kostoja për kilometër - Kostoja kapitale për përdoruesit e automjeteve - Vlera e produkteve të tregtuara/transportuara në një zonë të caktuar
Elektriciteti:	- Kostoja për KËH - Kostoja për konsumator - Konsumi për konsumator
Strehimi:	- Kostoja për metër katror - Sipërfaqja për njësi - Raporti kosto/e ardhur për banorë - Raporti qira/kosto
Automjetet:	- Numri i kilometrave - Numri i aksidenteve - Raporti staf/automjete - Sipërfaqe parkimi/numër automjetesh - Etj.



ANEKSI 1 (F-1)

F – 1 Formulari i Prezantimit të Projekt-Idesë (FPPI)

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit të projektit		Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit			
Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori		Vendndodhja e Projektit	

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Projekt-Ideja	
Emri i Programit	
Problemet për t'u adresuar	<i>Një përshkrim i gjendjes aktuale dhe problemet siç perceptohen nga përfituesit direkt të investimit. Dubet të kërket parasysh që përshkrimi i problemeve aktuale dhe nevojave për të ardhmen të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur të dhëna sasiore dhe cilësore</i>
Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen	<i>Të argumentohet përputhja e investimit me objektivat e programit në të cilin bën pjesë ky projekt. Ndërlidhja e projekt propozimit me:</i> 1. Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjinë Sektoriale 2. Deklaratën e prioriteteve të Qeverisë <i>(të jepen konkretisht lidhjet me dokumentet e mësipërme)</i>

0.3. Kostot e Projektit të Investimit

Kosto Totale e Projektit (000/lekë)	
-------------------------------------	--

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt-idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit-Idesë</i>
Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për t'u shqyrtuar më tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka)				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt-idesë
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (n.q.s. ka)				



ANEKSI 1 (F-2)

F-2 Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI)

01. Personat e Kontaktit

Institucioni Buxhetor		Departamenti	
Emri dhe pozicioni i propozuesit të projektit		Detajet e kontaktit të propozuesit të projektit (tel, email)	
Personi i kontaktit Buxhet & Financë		Detajet e kontaktit të Buxhet & Financë	

02. Identifikimi i Investimit

Ministria/grupi/sektori (Institucioni buxhetor)		Kodi i Grupit	
Emri i Programit		Kodi i Programit	
Emri i Projektit		Kodi i Projektit	
		Numri i identifikimit nga DMIP	
		Vendndodhja e Projektit	
Statusi i Projektit	I ri ☐	Financimi nga Donatori (n.q.s. ka)	
	Në vazhdim ☐		
Data e Fillimit		Data e Përfundimit	

03. Justifikimi i Investimit

Problemet e gjendjes aktuale që duhen adresuar/ Justifikimi i nevojës për investime
(Një përshkrim i gjendjes aktuale dhe problemet siç perceptohen nga përfituesit direkt të investimit. Duhet të kihet parasysh që përshkrimi i problemeve aktuale dhe nevojave për të ardhmen të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur të dhëna sasiore dhe cilësore).

Përputhja e projektit me Qëllimet dhe Objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të realizohen. A ndërlihet projekt-propozimi me:

3. Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjinë Sektoriale

4. Deklaratën e prioriteteve të Qeverisë
(të jepen konkretisht lidhjet me dokumentet e mësipërme)

0.4 Specifikimi i Projektit & Analiza e Alternativave të Investimit

▪ **Objektivi i Investimit:**
(Objektivi i Përgjithshëm” (impakti)” janë përfitimet afat gjata të cilat synon të arrijë investimi. Këto objektiva zakonisht përcaktohen në nivel Programi). Objektivat specifikojnë pse projekti është i nevojshëm për përfituesit direkt nga investimi).

Përshkrim i përgjithshëm i projektit: *(një përshkrim i detajuar çfarë projekti do të realizojë dhe lidhjet e tij me objektivat. Informacioni duhet të jetë sa më cilësor dhe sasior)*



Alternativa 1 -	Përshkrimi i alternativës së investimit 1		
Alternativa 2 -	Përshkrimi i alternativës së investimit 2 (në është identifikuar)		
Alternativa 3 -	Përshkrimi i alternativës së investimit 3 (në është identifikuar)		
Alternativa e Investimit (e përzgjedhur)	Arsyet për zgjedhjen e alternativës së investimit		
Produktet që do të realizojë ky investim: (mallrat apo shërbimet e realizuara nga investimi për arritjen e rezultateve dhe objektivave të përcaktuara. Ato duhet të jenë të matshme dhe të prekshme)			
	Sasia e Produktit	Njësia Matëse	Kosto për njësi
Produkti 1			
Produkti 2 (nëse ka)			
Produkti 3 (nëse ka)			

0.6 Kostot (shpenzimet kapitale) e mëparshme të projektit

Kosto e investimit deri në fund të 2017 (n.q.s. ka), 000/lekë (kjo vlen në rastin e kontratave shitesë apo projekte të cilat kanë qenë financuar më parë)	
--	--

0.7 Kostot e Investimit / Të Ardhurat nga Investimi (000/Lekë)

Kostot e Projektit të Investimit	2018	2019	2020	Kostoja e mbetur e investimit	Kosto totale e Investimit
(a) Kosto e investimit					
(b) Kosto korente/operative					
(c) Totali (a+b)					
(d) Të ardhurat si rezultat i investimit (n.q.s. ka)					
(e) Financimi nga donatorët (n.q.s. ka)					
(f) Kostoja Neto (c-d-e) (kontributi i buxhetit të shtetit për këtë investim)					

08. Menaxhimi i Projektit, parakushtet & rreziqet

Parakushtet dhe Rreziqet në zbatimin e projektit; dhe veprimet e planifikuara për eliminimin e efektit të tyre
a. Duhet evidentuar çfarë faktorësh të jashtëm mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të projektit, por që janë jashtë kontrollit të menaxhuesve të projektit? b. Specifikoni ndonjë nevojë për rregullim ligjor apo masa rregullatore, të cilat duhet të ndërmerren si parakusht për fillimin e projektit për investim.



Përmbledhje e mënyrës dhe rolit të institucioneve që do të menaxhojnë projektin. <i>a. Përcakto fazat/ rezultate të ndërmjetme, nëse ka dhe bashkëngjiti atyre afate kohore që mund të përdoren për të treguar progresin në zbatimin e projektit.</i> <i>b. Përcakto emrin e drejtorisë dhe drejtuesi i cili do të jetë përgjegjës për projektin apo ndonjë institucion tjetër që do të ngrihet për zbatimin/ menaxhimin e projektit.</i>	
1. Hartimi i Projekt-Idesë 2. Hartimi i Projektit teknik (me preventivin përkatës) (vendos shenjën X brenda kutisë nëse është realizuar)	☐ ☐
Dokumentet e mëposhtme kërkohen vetëm për “nivele të mesme ose të plotë” (vendos shenjën X brenda kutisë nëse është realizuar)	
3. Studimi i fizibilitetit i pjesshëm/zhvilluar 4. Analiza të tjera ekonomike financiare <i>(Në këtë bllok kërkohet të jepet një përmbledhje e shkurtër e konkluzioneve të arritura nga studimet e kryera. Të paraqiten treguesit kryesorë të këtyre analizave. Në rastin e analizës kosto-përfitim të jepen: VAN (Vlera aktuale Neto), NBR (Norma e Brendshme e Kthimit), RKP (Raporti Kosto-Përfitim) si dhe një vlerësim nëse këta tregues kanë kuptim.</i>	☐ ☐

09. Vlerësime të tjera për projektin

Vlerësimi i impaktit mjedisor Vlerësimi i impaktit social (ulja e varfërisë, barazia gjinore, minoritetet) Të tjera - (specifiko)	☐ ☐ ☐
---	--

10. Autorizuesit e aprovimit të projektit

	Emri	Nënshkrimi	Data
Drejtuesi i Programit të Institucionit Buxhetor (IB)			
Drejtuesi i Financës/Buxhetit të Institucionit buxhetor			
Drejtuesi i Institucionit Buxhetor (Sekretari Përgjithshëm)			



ANEKS 2: METODOLOGJIA

“PËR MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E INVESTIMEVE PUBLIKE”

Rregullat e mëposhtme do të aplikohen në procesin e monitorimit dhe raportimit të investimeve publike.

1. Rregulla të Përgjithshme të Monitorimit

Monitorimi është procesi përmes të cilit institucionet buxhetore, përgjegjëse për zbatimin e projekteve të investimeve publike, sigurojnë që realizimi financiar i projekteve dhe aktivitetet që ato po zbatojnë në këtë kuadër, janë në përputhje me planet vjetore të miratuara në nivel projekti.

Monitorimi do të zhvillohet si një *proces sistematik*, i cili ka për qëllim të krahasojë performancën e investimeve në tërësi me objektivat për të cilat janë programuar, si dhe marrjen në kohë të masave paraprake për mënjanimin e risqeve dhe problemeve gjatë realizimit të projekteve të investimeve.

Monitorimi i projekteve të investimeve publike do të bëhet duke marrë parasysh specifikat dhe procedurat që ndiqen në zbatimin e projekteve sipas burimit të financimit.

Qëllimi

Metodologjia e Monitorimit dhe Raportimit të Investimeve Publike ka për qëllim të standardizojë formën dhe mënyrën e raportimit nga ana e ministrive. Kjo metodologji është në sinkron me udhëzimet për hartimin dhe zbatimin e buxhetit dhe rregullon marrëdhëniet ndërinstitucionale në fushën e monitorimit dhe raportimit të investimeve publike në përputhje me përgjegjësitë shtetërore të ministrive.

Objektivat e monitorimit të projekteve të investimeve publike**- Të përmirësojë eficiencën e sistemit aktual të monitorimit të investimeve publike:**

Sistemi i monitorimit synon një raportim efikas dhe realist që identifikon në kohë dhe i paraprin akumulimit të problemeve, duke vënë në dijeni strukturat vendimmarrëse me qëllim zgjidhjen në kohë të tyre.

- Të përmirësojë procesin e planifikimit vjetor dhe afatmesëm në nivel programi dhe projekti:

Gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit do të ndihmojnë ministrinë të përmirësojnë mënyrën e planifikimit të projekteve, duke mundësuar një përqasje më të mirë në raport me arritjen e objektivave sektoriale, rishikimin e politikave dhe buxhetimin e programeve.

- Të përmirësojë kuadrin institucional të monitorimit e raportimit si dhe përgjegjësitë në procesin e planifikimit

Ministria përgjegjëse për financat përgjigjet për përgatitjen e standardeve dhe metodologjisë së raportimit si dhe për vlerësimin periodik të projekteve dhe programeve të investimeve publike. Sipas rastit, ministria përgjegjëse për financat propozon zgjidhje të mundshme të problemeve të projekteve, në bashkëpunim me ministrinë e linjës.

2. Procedurat e Monitorimit dhe Raportimit të Investimeve Publike**Fusha /Objekti i raportimit**

Objekt i monitorimit dhe raportimit nga ana e ministrive dhe institucioneve buxhetore që zbatojnë projekte të investimeve publike, do të jenë të gjitha projektet e investimeve publike që financohen në kuadër të buxhetit të shtetit, pavarësisht burimit dhe vlerës së financimit.

Burimi i të dhënave të monitorimit dhe forma e raportimit

Të dhënat bazë për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të investimeve publike do të gjenerohen nga raportimet e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera buxhetore që zbatojnë projekte me financim të brendshëm dhe të huaj, dhe nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Sipas rastit, mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera të dhënash.

Forma dhe mënyra e raportimit të investimeve publike do të përcaktohet nga Ministri përgjegjës për financat në fillim të vitit buxhetor.



Afatet e Raportimit

Raportimi për ecurinë e realizimit të investimeve publike do të bëhet në mënyrë periodike në bazë mujore. Raportimi mbi bazë mujore ka për qëllim disiplinimin e investimeve, evidentimin dhe shmangien në kohë të problematikës që haset në zbatimin e projekteve. Raportimi do të bëhet sipas standardit të parashikuar në seksionin e mësipërm.

Të gjitha institucionet buxhetore që zbatojnë projekte investimi, brenda datës 10 të çdo muaji duhet të dërgojnë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike raportet e monitorimit për muajin paraardhës. Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë përgjegjëse për financat, brenda datës 20 të çdo muaji përditëson raportin përmbledhës të monitorimit të investimeve për periudhën. Raporti vjetor i monitorimit të investimeve publike për periudhën ushtrimore hartohet brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

Kuadri institucional i monitorimit

Ministria përgjegjëse për financat është institucioni përgjegjës për përcaktimin e standardeve të monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë së zbatimit të investimeve në përputhje me prioritetet e miratuara në fillim të vitit buxhetor. Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë përgjegjëse për financat përgjigjet për ndjekjen dhe respektimin e afateve të raportimit, garantimin e cilësisë së raportimit nga ana e ministrive dhe institucioneve buxhetore që zbatojnë projekte investimi, si dhe përgatitjen e raporteve përmbledhëse periodike dhe vjetore të monitorimit të investimeve.

Ministritë dhe institucionet buxhetore përcaktojnë strukturat përgjegjëse për raportimin pranë Ministrisë përgjegjëse për financat /Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike, të cilat raportojnë në mënyrë periodike, në rrugë shkresore dhe elektronike, në përputhje me formatet e raportimit. Strukturat përgjegjëse për monitorimin bëjnë verifikimin, dhe sipas rastit edhe korrektimet apo plotësimet e nevojshme të informacionit të dërguar nga drejtoritë ose institucionet e varësisë, në përputhje me specifikimet e përcaktuara në formatet e parashikuara të kësaj metodologjie. Çdo ministri, brenda sistemit të vet dhe në përputhje me programet që menaxhon, do të ndërtojë skemën e raportimit të brendshëm për të gjitha strukturat brenda ose jashtë saj, që zbatojnë projekte të investimeve publike.

Ministritë dhe institucionet buxhetore, si institucione përgjegjëse për kontraktimin dhe zbatimin e projekteve, kanë një rol të dyfishtë: evidentimin e termave kontraktuale të projekteve, ndjekjen e zbatimit të projekteve dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve në përputhje me kontratat e lidhura për çdo projekt.

Lidhja e procesit të monitorimit me planifikimin dhe buxhetimin e projekteve

Planifikimi dhe monitorimi janë ngushtësisht të ndërlidhur, ku një proces ndjek tjetrin ashtu sikundër edhe derivohet nga tjetri. Në këtë kontekst, monitorimi i investimeve publike përbën një instrument për të korriguar jo vetëm planifikimin e projekteve, por edhe një menaxhim më efikas të shpenzimeve për investime. Gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit do të ndihmojnë ministritë në planifikimin dhe prioritizimin e projekteve të investimeve përgjatë gjithë ciklit të projektit si dhe një harmonizim më të mirë të ciklit të projekteve me ciklin e menaxhimit të shpenzimeve publike.

Në përputhje me ciklin e buxhetimit të projekteve dhe të përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit, raporti për progresin 6-mujor të zbatimit të investimeve do të shërbejë si bazë për rialokime të mundshme të shpenzimeve për investime në kuadër të rishikimit të buxhetit të shtetit. Raporti 9-mujor do të jetë raporti kryesor për vlerësimin e realizimit të pritshëm vjetor të investimeve si dhe përgatitjen e propozimeve për tavanet sektoriale të investimeve publike në kuadër të hartimit të projektbuxhetit për vitin në vazhdim.

Raporti vjetor i monitorimit të investimeve publike do të përmbajë konkluzionet lidhur me zbatimin e investimeve përgjatë periudhës ushtrimore dhe do të shërbejnë si bazë për përgatitjen e taveve institucionale për investimet publike në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm. Konkluzionet e raportit vjetor të monitorimit do të jenë pjesë e raportit për buxhetin faktik që miratohet çdo vit në Kuvend.

**VENDIM****Nr. 186, datë 29.3.2018****PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR
MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR
REALIZIMIN E AKTIVITETEVE, PJESË
TË KALENDARIT PËR VITIN 2018, SI
“VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ
KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, i shtohet fondi prej 52 200 000 (pesëdhjetë e dy milionë e dyqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve që do të

realizohen në kuadër të vitit 2018, si “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

2. Fondi prej 52 200 000 (pesëdhjetë e dy milionë e dyqind mijë) lekësh ndahet, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor “Trashëgimia kulturore dhe muzetë” (08220), zëri “Shpenzime korente”, llog. 604, fondi prej 14 200 000 (katërmëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekësh;

b) Në programin buxhetor “Art & kultura” (08230), zëri “Shpenzime korente”, llog. 604, fondi prej 38 000 000 (tridhjetë e tetë milionë) lekësh.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë